



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E TIRANËS

Drejtuar: Operatorin ekonomik “AGI KONS” shpk & “BE - IS” shpk

Adresa: Tiranë, Farke Kodra e Diellit 2, Kompleks Hotelerie me struktura 2.3 dhe 5 kate, me dy kate nen toke, Nr. pasurie 51/256

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)**

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar” “Godina e Teatrit Tiranë - Faza I-rë”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Godina e Teatrit Tiranë - Faza I-rë”.

2. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-44309-10-03-2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Fondi limit: 1,854,828,635 (një miliard e tetëqind e pesëdhjetë e katër milion e tetëqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: miratuar me VKB Nr.73, datë 26.07.2022 “Për disa ndryshime në VKB Nr. 166, datë 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2022 (e ndryshuar)”.

Kohëzgjatja e kontratës: 27 (njetzet e shtate) muaj kalendarik duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 14.11.2022, ora 10:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.139 datë 10.10.2022.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “DON JURGE” shpk

NUIS K33005405Q

Vlera e ofertës: **0** (zero) lekë pa TVSH

2. Operatori ekonomik “Edurat Çela”

NUIS M03806202I

Vlera e ofertës: **0** (zero) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “ADMC Internacional” shpk & “ED KONSTRUKSION” shpk

NUIS L81405032D & NUIS K61625001I

Vlera e ofertës = 1,641,468,214 (një miliard e gjashtëqind e dyzet e një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e katërmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “AGI KONS” shpk & “BE - IS” shpk

NUIS K21622001M & NUIS K71412003A

Vlera e ofertës = **1,840,784,139.32** (një miliard e tetëqind e dyzet milion e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëqind e tridhjetë e nëntë pikë tridhjetë e dy) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “4 A-M” shpk & “ARKONSTUDIO” shpk

NUIS K92005016L & NUIS L42019004I

Vlera e ofertës = **1,849,314,974.75** (një miliard e tetëqind e dyzet e nëntë milion e treqind e katërmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

6. Operatori ekonomik “HASTOÇI” shpk

NUIS J62028009B

Vlera e ofertës = **1,854,266,083.61** (një miliard e tetëqind e pesëdhjetë e katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë e tre pikë gjashëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsytet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “DON JURGE” shpk

- Operatori Ekonomik **DON JURGE shpk**, nuk ka plotësuar asnje nga kerkesat e percaktuara ne Dokumentat Standart te Tenderit.

2. Operatori ekonomik Eduart Çela

- Operatori Ekonomik **Eduart Çela**, nuk ka plotësuar asnje nga kerkesat e percaktuara ne Dokumentat Standart te Tenderit.

3. Operatori ekonomik “ADMC Internacional” shpk & “ED KONSTRUKSION” shpk

Operatori ekonomik “Ed Konstruksion” shpk nuk përmbush kërkesat e pikës 2.3 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, ku percaktohet: *Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: “Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 927,414,317.5 (nëntëqind e njëzet e shtatë milion e katërqind e katërbëdhjetë mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë pikë pesë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës” ose “Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë 5 (pesë) viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 3,709,657,270 (tre miliard e shtatëqind e nëntë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH”.* Plotësimi i njerit prej dy kushteve të siperpërmendura e ben oferten të kualifikueshme. Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në sistemin elektronik të prokurimit për punët e ngjashme rezulton se operatori ekonomik Ed Konstruksion shpk nuk plotëson kërkesat 1/a dhe 1/b, të pikës 2.3 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, as për një kontratë të vetme dhe as për disa kontrata. Operatori ekonomik Ed Konstruksion shpk duhet të disponojë për përmbushjen e pikës 1, a) një kontrate të vetme të realizuar në 5 (pesë) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në shumën totale prej 927,414,317.5 lekë pa TVSH. Pas verifikimit të punëve të ngjashme të paraqitura rezulton se asnjë kontratë nuk e përmbush këtë vlerë të vetme. Për përmbushjen e pikës 1, b), operatori ekonomik Ed Konstruksion Shpk sipas marrëveshjes së bashkëpunimit duhet të disponojë punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë 5 (pesë) viteve të fundit të jete në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet sipas përqindjes së marre përsiper. Pas verifikimit të punëve të ngjashme të paraqitura nga operatori ekonomik Ed Konstruksion shpk rezulton se vlera totale e kontratave të paraqitura si punë të ngjashme nuk përmbush vlerën e kërkuar.

Operatori ekonomik “ADMC Internacional” shpk nuk përmbush kërkesat e pikës 2.3 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, ku percaktohet: *Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: “Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 927,414,317.5 (nëntëqind e njëzet e shtatë milion e katërqind e katërbëdhjetë mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë pikë pesë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës” ose “Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë 5 (pesë) viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 3,709,657,270 (tre miliard e shtatëqind e nëntë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.....”.* Nga verifikimi i punëve të ngjashme të paraqitura nga operatori ekonomik “ADMC Internacional” shpk rezulton se kontrata e paraqitur si punë e ngjashme nuk përmbush vlerën e kërkuar sipas pika 1, 2.3, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

Operatori ekonomik “Ed konstruksion” shpk nuk plotëson kërkesat e percaktuara në Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 1 “Kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 3,709,657,270 (tre miliard e shtatëqind e nëntë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori

ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor”. Nga verifikimi i dokumentit “Vërtetim” te paraqitur në SPE me nr.T06864063.prot, datë 20.09.2022, rezulton se Operatori ekonomik “Ed konstruksion” shpk nuk përmbush vlerën e kërkuar në asnjë nga vitet e kërkuara 2019, 2020, 2021.

Operatori ekonomik “ADMC Internacional” shpk nuk plotëson kërkesat e percaktuara në Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 1 “Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 3,709,657,270 (tre miliard e shtatëqind e nëntë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor”. Nga verifikimi i dokumentit “Vërtetim”, te paraqitur në SPE me nr.T06613163.prot, datë 05.08.2022, rezulton se Operatori ekonomik “ADMC Internacional” shpk nuk përmbush vlerën e kërkuar në asnjë nga vitet e kërkuara 2019, 2020, 2021.

Operatori ekonomik ADCM Internacional shpk nuk përmbush pikën 4, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, të dokumenteve të tenderit, ku kërkohet “Një punësim mesatar i të paktën 220 (dyqind njëzet) personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave...”, Sipas marrëveshjes së bashkëpunimit operatori ekonomik ADCM Internacional shpk ka marrë përsiper 30.24 % te punimeve, per rrjedhjoje duhet te kete minimumi 66 punonjes. Nga verifikimi i deklarimit të bërë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik ADCM Internacional shpk ka deklaruar se numri i punonjësve për Korrik – Shtator 2022 është mesatarja 12 persona. Për rrjedhojë nuk përmbush kërkesat e dokumenteve të tenderit.

Operatori ekonomik “Ed Konstruksion” shpk nuk përmbush pikën 4, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, të dokumenteve të tenderit, ku kërkohet “Një punësim mesatar i të paktën 220 (dyqind njëzet) personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave...”, Nga verifikimi i deklarimit të bërë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik “Ed Konstruksion” shpk nuk ka deklaruar numrin e punonjësve të kërkuar.

Bashkimi i operatoreve ekonomik “ADMC Internacional” shpk & “Ed Konstruksion” shpk, nuk plotëson pikën 6, të Kriterëve te Veçanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, ku percaktohet se: Operatori pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te perfshire ne licensen e shoqerise ose pajisur me license individuale, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë ne listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

- 2 (dy) Inxhinier Ndertimi Profili Strukturist
- 2 (dy) arkitekt
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 2 (dy) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;
- 1 (një) inxhinier Mjedisi;
- 1 (një) inxhinier Gjeolog;
- 1 (një) inxhinier Gjeoteknik

Nga verifikimi i formularit permbledhes te vetedeklarimit, paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezulton se bashkimi i operatoreve ekonomik “ADMC Internacional” shpk & “Ed Konstruksion” shpk nuk ka deklaruar 1 (një) Inxhinier Elektrik, 1 (një) Inxhinier Mekanik, 1

(një) Inxhinier Gjeolog si dhe 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik për rrjedhojë nuk përmbush kërkesat e dokumenteve të tenderit.

Operatori ekonomik “ADMC Internacional” shpk nuk përmbush Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, konkretisht, pika 1, germa c, lidhur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, “Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik”, rezulton se operatori ekonomik nuk ka deklaruar në kolonën përkatëse përqindjen e nënkontraktimit të shoqërisë Rizzani de Eccher, të deklaruar në këtë procedurë si nënkontraktor.

Operatori ekonomik “Ed Konstruksion” shpk nuk përmbush Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, konkretisht, pika 1, germa c, lidhur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, “Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik”, rezulton se operatori ekonomik nuk ka deklaruar në kolonën përkatëse përqindjen e nënkontraktimit të shoqërisë Rizzani de Eccher, të deklaruar në këtë procedurë si nënkontraktor.

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, të paraqitur nga Operatori ekonomik ADCM Internacional shpk, rezulton se në deklaratën B “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” për paragrafin “*Shënim: nëse ofertuesi do të mbështetet edhe në fuqinë punëtore të subjekte të tjera, duhet të deklarojë: Operatori ekonomik do të mbështetet në kapacitetet njerëzore (fuqinë punëtore), të subjektit mbështetës, i cili do të vërë në dispozicion punonjës, (me profesionet përkatëse...*”, ka deklaruar se do të mbështetet në kapacitetet njerëzore (fuqinë punëtore), të subjektit mbështetës, Rizzani de Eccher për 1 punonjes arkitekt. Pas verifikimit në sistemin elektronik të prokurimit rezultoi se subjekti mbështetës Rizzani De Eccher nuk ka paraqitur formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8, të percaktuar në dokumentat standarte të tenderit, çka bie në kundërshtim me Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit, dokumentet standarte të tenderit, ku përcaktohet se: “*Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës*”.

Bashkimi i operatoreve ekonomik “ADMC Internacional” shpk & “Ed Konstruksion” shpk, nuk plotëson pikën 7, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, ku përcaktohet se: “*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë: 2 (dy) Teknik ndertimi, 1 (një) Teknik mekanik, 2 (dy) punonjes hidraulike, 3 (tre) punonjes elektriciste, 2 (dy) punonjes mekanike, 2 (dy) punonjes bojaxhi, 2 (dy) punonjes murator, 2 (dy) punonjes saldatore, 2 (dy) punonjes hekurkthyes, 2 (dy) punonjes karpentiere, 2 (dy) punonjes pllakashtrues, 2 (dy) punonjes hidroizolues*”. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezulton se bashkimi i operatoreve ekonomik “ADMC Internacional & Ed Konstruksion” shpk, nuk ka deklaruar 1 (një) Teknik mekanik, 1 (një) punonjes hidraulik, 3 (tre) punonjës elektrikist dhe 1 (një) punonjes hidroizolues.

Operatori ekonomik “ADMC Internacional” shpk, nuk plotëson pikën 12, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik ku përcaktohet se: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë menaxhimin të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor ISO 39001-2012 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*”, pasi nga verifikimi në sistemin elektronik të prokurimit rezultoi se operatori ekonomik “ADMC Internacional” shpk, nuk ka paraqitur certifikatën ISO 39001:2012.

4. Operatori ekonomik “HASTOÇI” shpk

Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk plotëson gërmën “b” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3...”* pasi nga verifikimi i dokumenteve të dorëzuara në sistemin elektronik të prokurimit rezultoi se Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk ka paraqitur Sigurimin e ofertës.

Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk plotëson pikën 1, Kapaciteti teknik, të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 3,709,657,270 (tre miliard e shtatëqind e nëntë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH. ...”*, pasi nga verifikimi i dokumentit “Vërtetim” Nr. T07221084 Prot., datë 11.11.2022, dorëzuar në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se Operatori ekonomik “HASTOÇI” shpk nuk përmbush vlerën e kërkuar të xhiros në asnjë nga vitet e kërkuara 2019, 2020, 2021.

Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk plotëson pikën 4, Kapaciteti teknik, të Dokumenteve Standarte të Tenderit për: *“Një punësim mesatar i të paktën 220 (dyqind njëzet) personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me. ...”*, pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit është deklaruar një numër mesatar punonjësish prej 175 punonjësish, çka bie në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk plotëson pikën 6, të Kapacitetit Teknik, të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“ Operatori pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë ose pajisur me licensë individuale, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:*

- 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi Profili Strukturist
- 2 (dy) arkitekt
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 2 (dy) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;
- 1 (një) inxhinier Mjedisi;
- 1 (një) inxhinier Gjeolog;
- 1 (një) inxhinier Gjeoteknik;

pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit nuk ka deklaruar punonjësit: 1 (nje) inxhinier ndërtimi profile strukturë, 1 (një) inxhinier Mjedisi; 1 (një) inxhinier Gjeolog; 1 (nje) Inxhinier Mekanik; 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik.

Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk plotëson pikën 10, të Kapacitetit Teknik, të Dokumenteve Standarte te Tenderit: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet elektrike, tuba, hidroizolues. Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike” pasi nga verifikimi i dokumenteve të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit rezulton se operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori.

Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk plotëson pikën 11, të Kapacitetit Teknik, të Dokumenteve Standarte te Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 27 (njëzet e shtatë) muaj kalendarike...” pasi nga verifikimi i dokumenteve të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit rezulton se operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk ka paraqitur grafikun e punimeve.

Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk plotëson gërmën “a” të pikës 12, të Kapacitetit Teknik, të Dokumenteve Standarte te Tenderit: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë: Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015*”, pasi nga verifikimi i dokumenteve të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit rezulton se operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk ka paraqitur Çertifikatën ISO 9001:2015.

Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk plotëson gërmën “b” të pikës 12, të Kapacitetit Teknik, të Dokumenteve Standarte te Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë: Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015”. pasi nga verifikimi i dokumenteve të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit rezulton se operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk ka paraqitur Çertifikatën ISO 14001-2015.

Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk plotëson gërmën “c” të pikës 12, të Kapacitetit Teknik, të Dokumenteve Standarte te Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë: Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 45001-2018”. pasi nga verifikimi i dokumenteve të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit rezulton se operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk ka paraqitur Çertifikatën ISO 45001-2018.

Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk plotëson gërmën “d” të pikës 12, të Kapacitetit Teknik, të Dokumenteve Standarte te Tenderit: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë Çertifikatën e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor ISO 39001-2012 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 39001-2012. pasi nga*

verifikimi i dokumenteve të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit rezulton se operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk ka paraqitur Çertifikatën ISO 39001-2012.

Operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk plotëson gërmën “e” të pikës 12, të Kapacitetit Teknik, të Dokumenteve Standarte te Tenderit: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë: “Çertifikatën e menaxhimit te energjise ISO 50001-2011 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, certifikata ISO 50001-2011 do të paraqitet nga Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave te punimeve elektrike sipas preventivit”, pasi nga verifikimi i dokumenteve të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit rezulton se operatori ekonomik “Hastoçi” shpk nuk ka paraqitur Çertifikatën ISO 50001-2011.*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “AGI KONS” shpk & “BE - IS” shpk**, me adresë: *Tiranë, Farke Kodra e Diellit 2, Kompleks Hotelerie me struktura 2.3 dhe 5 kate, me dy kate nen toke, Nr. pasurie 51/256*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **1,840,784,139.32** (një miliard e tetëqind e dyzet milion e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëqind e tridhjetë e nëntë pikë tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, me adresë: *Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **1,849,314,974.75** (një miliard e tetëqind e dyzet e nëntë milion e treqind e katërmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa: **Nuk ka pasur.**